

Në bazë të nenit 38, nenit 39 dhe nenit 45-a të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 27/2014, 145/15, 154/15, 30/16, 53/16 dhe 257/2020), nenit 22 nga Ligji për marrëdhëniet e punës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 1 14/2003, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015 dhe 129/2015), Vendimit të Këshillit të Institutit nga seanca e 204 e mbajtur më 25.10.2023 dhe Rregullores së vendeve të punës së IPSH Institutit të Trashëgiminë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup dhe pëlqimit me numër 18-10138/2 të datës 22.9.2023 nga Ministria e Financave, shpallet:

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhje në thirrjen bashkëpunëtor bashkëpunëtor hulumtues dhe formimin e marrëdhënieve të punës së një bashkëpunëtor hulumtues në IPSH Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, në Departamentin e Gjuhës shqipe, sfera 5 shkenca shoqërore - fusha 505 arsim

1. IPSH Instituti i Trashëgiminë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup shpall konkurs publik për zgjedhje në thirrjen bashkëpunëtor bashkëpunëtor hulumtues dhe formimin e marrëdhënieve të punës së një bashkëpunëtor hulumtues në departamentin si vijon:

I - Zgjedhja e bashkëpunëtorit hulumtues dhe formimin e marrëdhënieve të punës në Departamentin e Gjuhës shqipe.

1.2 Kushte të posaçme:

Kërkohej që kandidatët të plotësojnë kriteret për zgjedhje / rizgjedhje në titujt mësimorë - shkencorë, të përcaktuara sipas Ligjit për hulumtim shkencor, Ligjit për arsimim të lartë, Rregullores për mënyrën dhe procedurën e përzgjedhjes në titull të lartë shkencor, Rregullores për procedurën dhe kriteret me të përafërta për përzgjedhjen e hershme në titujt shkencorë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 82/09), nga sfera ku zgjedhet;

- ciklin e parë të studimeve të përfunduar në sferën 5 shkenca shoqërore – fusha 505 arsim

1.3 Kushte shtesë:

- Njohuri aktive në të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);

1.4. Orari i punës dhe paga:

- Orari i punës ditore nga ora 08:30 deri në 16:30
- Orë pune javore 40 orë të punës (nga e hëna në të premte)
- Paga bazë neto 32.300 denarë.

2. Kandidatët që aplikojnë, bashkë me fletëparaqitjen sipas konkursit publik, duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Fletëparaqitje,
2. Biografi dhe bibliografi e shkurtër,
3. Diplomë për ciklin e parë të studimeve të përfunduara, në origjinal ose kopje të noterizuar.
4. Dëshmi për njohjen e gjuhës (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) origjinale ose e noterizuar.
5. Shtetësi, jo më e vjetër se 6 muaj.

3. Konkursi zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e shpalljes.

Zgjedhja kryhet brenda periudhës së parashikuar në nenin 38 të Ligjit për veprimtarinë kërkimore shkencore (deri në 6 muaj nga shpallja e konkursit publik).

4. Dokumentet dorëzohen në IPSH Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup në njërin prej mënyrave të mëposhtme - me postë në adresën e Institutit: Shkup, kutia e postës 171 ose personalisht (bulevardi Ilinden, numër 99 - ish ambasada amerikane).

5. Aplikimet e pakompletuara dhe ato që nuk dorëzohen në kohë me dokumentacionin, nuk do të merren parasysh.

